REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA CUMHURIYETI
KOMUNA E GJILANIT - OPŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIYE
02 nr/br/No 4036
Data/Datum/Tarih 18.09.24
GJILAN - GNJILANE - GILAN

**REPUBLIKA E KOSOVËS**

**REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO**

**KOMUNA E GJILANIT**

# PLANI KOMUNAL PËR INTEGRITET
# 2024 - 2026

# KOMUNA E GJILANIT

Janar 2024

PËRMBAJTJE

**Deklarata e Integritetit** ........ 3

**Hyrja** ........ 5

**PERMBAJTJA E PLANIT TË INTEGRITETIT** ........ 6

Qëllimet e Planit të Integritetit ........ 6

Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit ........ 7

Metoda e vlerësimit të rrezikut ........ 7

Monitorimi i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi ........ 9

Fushat e rrezikut ........ 9

Fushat e përgjithshme të rrezikut ........ 9

Fushat specifike të rrezikut ........ 9

# Deklarata e Integritetit

Ne, në vazhdimësi bëjmë përpjekje të fuqishme për të rritur efikasitetin, trajtimin dhe cilësinë e shërbimeve publike dhe kështu në mënyrë të dukshme dhe të konsiderueshme, përmirësojmë kushtet e jetesës dhe të biznesit për komunitetin lokal.

Ne jemi të vetëdijshëm për mundësitë e sjelljeve keqpërdoruese dhe korruptive, për shkak të fushës së gjerë të ofrimit të shërbimeve dhe të shpenzimeve të buxhetit të planifikuar vjetor. Ekziston një potencial serioz, për ushtrim të parregullt të pushtetit të monopolit, të cilin ne duhet ta menaxhojmë me llogaridhënie, me përgjegjësi dhe me efikasitet.

Ne gjithashtu e kuptojmë mirë mandatin tonë për ta luftuar korrupsionin lokal. Drejtuesit e komunës janë të vendosur të zbatojmë me vendosmëri politikën "zero tolerancë" ndaj korrupsionit, kur ai zbulohet dhe të sigurojë se korrupsioni, mashtrimi, keqadministrimi apo çdo shkelje tjetër e integritetit apo e ndonjë natyre të ngjashme, nuk do të tolerohet. Të gjitha shkeljet e mundshme do të hetohen dhe ndaj atyre që janë përgjegjës, do të merren masa. Këtu hyjnë edhe ngritja e akuzave penale, veprimet administrative dhe korrigjime sipas nevojës.

Është përgjegjësi e të gjithë stafit tonë, që të gjitha incidentet e mashtrimit dhe të korrupsionit, apo shkeljet e tjera të integritetit me natyrë të ngjashme, t'i raportojë tek mbikëqyrësit e tyre. Një tjetër mënyrë raportimi do të bëhet përmes paraqitjes së informacionit përmes mekanizmit të caktuar për paralajmërim. Këto do të trajtohen me konfidencialitetin më të thellë dhe nuk do të zbulohen apo diskutohen me palë të tjera, përveç atyre që janë ngarkuar me hetimin e këtyre raportimeve. Në mënyrë që të sigurohen informata nga burime të ndryshme të mbikëqyrjes së qytetarëve, ne inkurajojmë të gjithë ata që kanë informacione për korrupsion apo shkeljeve tjera të integritetit, të raportojnë përmes linjës telefonike kundër korrupsionit si një mekanizëm funksional për raportim.

Ne do të bëjmë përpjekje të vazhdueshme, të përcaktojmë ekspozimet e mundshme të organeve të administratës komunale, kushteve të tyre organizative, proceseve dhe punonjësve, ndaj korrupsionit dhe sjelljeve tjera të paligjshme dhe jo etike. Duke identifikuar rreziqet, planifikimin dhe zbatimin e masave adekuate, ne forcojmë integritetin dhe kulturën kundër-korrupsion në punën e organeve të administratës komunale. Përmes planit të integritetit, ne eliminojmë shkaqet e korrupsionit të cilat mundësojnë forcimin e sundimit të ligjit dhe besimin e qytetarëve në punën e organeve të administratës komunale.

Të gjithë ne jemi përgjegjës për parandalimin efikas, zbulimin me kohë dhe hetimin e korrupsionit, mashtrimit apo çdo shkeljeje tjetër të integritetit në komunë. Ne jemi të vendosur që: në realizimin e mandatit dhe detyrave tona, të veprojmë ndershëm, guximshëm, të matur, moralshëm, drejtë dhe me profesionalizëm. Të mos përdorim asnjëherë detyrën zyrtare si dhe qasjen e besuar në resurset publike, duke përfshirë qasjen në informata për përfitime personale për ne apo të tjerët, apo për qëllime të avancimit në detyrë.

Të ndërmarrim të gjithë hapat e nevojshëm për të parandaluar dhe zgjidhur çfarëdo konflikti real, të dukshëm apo potencial të interesit ndërmjet përgjegjësive tona zyrtare dhe çështjeve tona private në të mirë të interesit publik. Të përmbahemi nga përfshirja në çfarëdo biznesi apo transaksioni apo nga të pasurit e çfarëdo interesi financiar, apo interesi tjetër personal, që është apo mund të dalë të jetë në përputhje jo të plotë me kryerjen e detyrave zyrtare. Të shmangim nepotizmin dhe favorizimin në punësim dhe ofrimin e shërbimeve komunale. Të përmirësojmë konsiderueshëm politikat tona parandaluese të korrupsionit, duke zbatuar me përpikëri planin e integritetit. Të përmbahemi nga çfarëdo sjellje që mund të humbë vlerën e imazhit të integritetit apo profesionalizmit të komunës.

Andaj, unë deklaroj përkrahjen time të plotë dhe përkushtimin tim maksimal, për të gjitha përpjekjet që fuqizojnë, zhvillojnë dhe përmirësojnë vazhdimisht sistemin e menaxhimit të integritetit brenda Komunës së Gjilanit.

Kryetari i Komunës

# Hyrja

Në pajtim me nenin 25 Ligjit nr.08/I-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe në përputhje me "Metodologjinë e Planeve të Integritetit" të cilat obligojnë të gjitha institucionet të hartojnë dhe miratojnë planet e integritetit, komuna e Gjilanit ka hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit për periudhën 2024 -2026.

Plani i integritetit është një dokument i brendshëm tre (3) vjeçar dhe përditësohet çdo vit.
Është një proces i dokumentuar për të vlerësuar nivelin e cenueshmërisë së integritetit brenda Institucionit dhe që ofron masa për menaxhimin e integritetit për të arritur objektivat e integritetit të Institucionit.

Plani rithekson përkushtimin e komunës së Gjilanit, për të shtuar dhe fuqizuar kontrollet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet brenda fushëveprimit të komunës.

Plani përshkruan masat e bazuara në rrezik për arritjen e objektivave të institucionit dhe forcimin e sundimit të ligjit, si dhe vlerat dhe standardet profesionale.

## PËRMBAJTJA E PLANIT TË INTEGRITETIT

Përmban elementet e mëposhtme:

- një vetëvlerësim të ekspozimit të institucionit ndaj korrupsionit dhe formave të tjera të shkeljes së integritetit;
- informacion për fushëveprimin e institucionit dhe burimet njerëzore të angazhuara në institucion;
- llojet e rreziqeve të korrupsionit dhe format e tjera të shkeljes së integritetit;
- masat ekzistuese të kontrollit;
- masat parandaluese për zvogëlimin e rrezikut të korrupsionit dhe format e tjera të shkeljes së integritetit dhe afatet për zbatimin e tyre;
- informacion për personin përgjegjës për menaxhimin e hartimit dhe zbatimit të planit të integritetit;
- të dhëna të tjera, në përputhje me Metodologjinë për hartimin e planit të integritetit.

Përmes Planit të Integritetit synohet:

- Rritja e mundësive që institucioni të arrijë objektivat e menaxhimit të integritetit;
- Identifikimi i rreziqeve dhe masave për zvogëlimin e rreziqeve;
- Përmirësimin e kontrolleve ndaj rreziqeve të identifikuara;
- Mbajtja e një sistemi për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat dhe standardet ligjore dhe procedurale;
- Rritja e besimit të stafit dhe palëve të jashtme të interesit në përkushtimin për integritet që demonstrohet nga Institucioni.

## Qëllimet e Planit të Integritetit

- Sistem efektiv i menaxhimit të integritetit në institucion;
- Llogaridhënie publike dhe transparencë;
- Rezistencë institucionale ndaj cenimeve të integritetit;
- Planifikim i menaxhimit të rrezikut ndaj integritetit në institucion.

## Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit

Zhvillimi i Planit të Integritetit përbëhet prej disa fazave si në vijim:

- Faza e parë: Drejtuesi/personi përgjegjës i institucionit merr vendim për emërimin e një Koordinatori dhe Grupit Punues për hartimin e Planit të Integritetit. Ky grup pune përbëhet nga anëtarë kredibil varësisht prej kompleksitetit të institucionit ose numrit të punonjësve. Grupi punues shqyrton kornizën ligjore (rregulloret, planet, kontrollin e brendshëm të auditimit, sistematizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës, si dhe burime të tjera informacioni për fushat dhe proceset e punës).

- Faza e dytë: Grupi punues ka mbajtur takime të rregullta me qëllim të përpunimit të të dhënave respektivisht përcaktimit të fushave të rrezikut dhe identifikimit të rreziqeve. Ndër të tjerash, takimet janë mbajtur më datë: 16.02.2023, 13.12.2023 dhe 12.01.2024. Përpos takimeve, jemi konsultuar në vazhdimësi përmes emailit dhe kemi kërkuar që anëtarët e grupit të dërgojnë komentet dhe propozimet e tyre në raport me Planin.

- Faza e tretë: Grupi punues ka përdorur të dhënat e siguruara për t'i përpiluar tabelat e rrezikut dhe të adresoj cenueshmërinë e integritetit dhe propozon masat për përmirësim. Në fund, komuna publikon planin e integritetit dhe miraton masat për përmirësimin e integritetit për periudhën tre (3) vjeçare.

### Metoda e vlerësimit të rrezikut

Metoda e Vlerësimit të rreziqeve përcakton probabilitetin e shfaqjes dhe pasojave të cenimit të integritetit dhe formave të tjera të sjelljes së paligjshme ose jo etike.

Përmes vlerësimit të rrezikut përcaktohet mundësia e ndodhjes dhe niveli i pasojës, i cili mund të jetë: i ulët/i mesëm/i lartë. Niveli përfundimtar i rrezikut përcaktohet sipas matricës së rrezikut, në formën e një kombinimi mes mundësisë dhe pasojës.

Figura 1 . Matrica e vlerësimit të rrezikut




Intensiteti i rrezikut fitohet duke shumëzuar probabilitetin/gjasën me pasojën/ndikimin, duke përdorur matricën e rrezikut, "ndikimi (1-10) x pasoja (1-10)", treguar në figurën si më lartë.

Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut të korrupsionit dhe formave të tjera të cenimit të integritetit, vlerësohet nga 1 në 100, si në tabelën e më poshtme:

| Ulët | Mesatar | Lartë |
|---|---|---|
| 1 - 15 pikë | 16 - 48 | 49 - 100 |

Rreziku me intensitet të ulët – mundësia e ndodhjes së korrupsionit ose formave tjera të cenimit të integritetit është shumë e vogël për shkak të masave ekzistuese të kontrollit.

Rreziku me intensitet të mesëm – ndodhja e korrupsionit ose formave tjera të cenimit të integritetit është e mundur, por masat e kontrollit menaxhojnë këtë rrezik.

Rreziku me intensitet të lartë – korrupsioni ose format e tjera të cenimit të integritetit janë tashmë të pranishëm në këtë proces ose ka të ngjarë të ndodhin.

## Monitorimit i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në vazhdimësi nga Zyrtari përgjegjës brenda institucionit dhe nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat për trajtim janë efektive, si në hartim ashtu edhe në zbatim, dhe se procedurat janë kuptuar, si dhe plani integritetit është ndjekur.

Gjithashtu, monitorimi duhet të përcaktojë nëse masat e përdorura për trajtimin e rreziku kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë zbuluar ndryshimet në kontekstin e jashtëm dhe të brendshëm përfshirë ndryshimet e vetë rrezikut, ndryshime që kërkojnë rishikimin e trajtimit dhe prioriteteve të rrezikut si dhe kanë identifikuar cilat mësime duhen nxjerrë për planifikim në të ardhmen.

Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i Planit bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planifikuara janë arritur. Gjithashtu, pas hartimit të raportit për zbatimin e planit të integritetit nga zyrtari përgjegjës brenda një institucioni, raporti duhet të dërgohet për vlerësim në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

## Fushat e rrezikut

### Fushat e përgjithshme të rrezikut

***Fushat e përgjithshme të rrezikut shembull janë***:

- Drejtimi dhe menaxhimi;
- Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve;
- Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit dhe financave; dhe
- Ruajtja dhe siguria e të dhënave dhe dokumentacionit.

### Fushat specifike të rrezikut

Fushat specifike mund të ndryshojnë varësisht nga specifikat e Institucionit.

***Fushat e specifike të rrezikut shembull janë:***

- Auditimi i brendshëm;
- Prokurimi publik;
- Menaxhimi i kontratave publike;
- Zhvillimi ekonomik lokal dhe bujqësia;
- Planifikimi urban dhe rural;
- Standardet e ndërtimit dhe kontrolli;
- Inspektimet;
- Arsimi publik;
- Shëndeti publik.

| FUSHAT E PËRGJITHSHME TË RREZIKUT | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Regjistrimi i rrezikut | | | Vlerësimi dhe matja e rrezikut | | | | Veprimi ndaj rrezikut | | |
| Nr. | Fusha e rrezikut | Përshkrimi i Rrezikut | Masat ekzistues e të kontrollit | Gjasat | Ndikimi | Vlerësimi i rrezikut | Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve | Njësia/zyrtari përgjegjës | Afati i realizimit |
| 1. | DREJTIMI DHE MENAXHIMI | Objektivat dhe prioritetet e zhvillimit të komunës të paqarta dhe jo transparente; | Ligjet dhe aktet nënligjore; Raportet periodike; aktet e brendshme të komunës, Plani i Integritetit | 5 | 8 | 40 | Rishikimi i Planit Zhvillimor | Kryetari i Komunës, drejtuesit e organeve dhe drejtuesit e drejtorive komunale | TM3 2024 |
| | | Mos përfshirja e të gjitha fushave përkatëse në Planin Zhvillimor. | | | | | Sigurimi i pjesëmarrjes së përfaqësuesve të të gjitha fushave përkatëse si dhe qytetarëve në zhvillimin e Planit Zhvillimor të komunës | | |
| | | Opinion publik negativ dhe humbja e besimit të publikut në punën e administratës komunale dhe Kuvendit Komunal | | 3 | 8 | 24 | Përditësimi i informatave në ueb faqen e Komunës për t'i informuar qytetarët dhe mediat për aktivitetet e komunës | Kryetari i Komunës, Kryetari i Kuvendit, drejtuesit e drejtorive komunale | Në vazhdimësi |
| | | | | | | | Përfshirja e vazhdueshme e shoqërisë civile në hartimin e politikave publike komunale. | Kryetari i Komunës, Kryetari i Kuvendit dhe drejtuesit e drejtorive komunale përkatëse | Në vazhdimësi |
| | | Mospërputhja dhe paqartësia e | | 3 | 7 | 21 | Rishikimi i organizimit të brendshëm të administratës përmes Rregullores për | Kryetari i komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e | TM2 2024 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | përgjegjësive në administratën komunale | | | | | organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës. | drejtorive dhe udhëheqësit e sektorëve | |
| | | Mos përcaktimi i qartë i përgjegjësive për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Planit të Integritetit | | 5 | 9 | 45 | Të përcaktohen përgjegjësitë sa i përket monitorimit dhe raportimit për zbatimin e Planit të Integritetit | Kryetari i Komunës dhe drejtuesit e njësive komunale | Pas miratimit të Planit të Integritetit |
| | | Mungesa e monitorimit, raportimit mbi zbatimin e Planit të Integritetit dhe mungesa e njohurive të stafit të administratës në lidhje me planin e integritetit | | 6 | 7 | 42 | Të monitorohet dhe raportohet rregullisht zbatimi i Planit të Integritetit | Mekanizmat përkatës të përcaktuara me vendim të Kryetarit të komunës | Së paku një herë në vit |
| | | | | | | | Të rishikohet niveli i zbatimit dhe të përditësohen masat për përmirësime. | Koordinatori i planit të integritetit | Një herë në vit |
| | | | | | | | Takime me stafin për t'i informuar për planin e ri të integritetit | Koordinatori i planit të integritetit | Pas miratimit |
| | | | | | | | Përfshirja e planit të integritetit në hartimin e planit komunal të trajnimeve | Njësia e Personelit | TM3 2024 |
| **2.** | **POLITIKA E BURIMEVE NJERËZORE, SJELLJA ETIKE DHE PROFESIONALE E TË** | Mos plotësimi i vendeve të punës me staf adekuatë dhe të mjaftueshëm | Ligjet, aktet nënligjore; dhe aktet e brendshme të komunës | 6 | 9 | 54 | Zhvillimi dhe miratimi i Planit të Personelit | Kryetari i komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive | TM4 2024 |
| | | | | 5 | 8 | 40 | Vlerësimi periodik për rezultatet e punës së zyrtarëve. | Kryetari i komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive | Në vazhdimësi |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | PUNËSUARV E | | | | | | Vendosja e kritereve të vlerësimit sipas Rregullores së klasifikimit. | Kryetari i komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive | |
| | | | | | | | Trajnimi i vazhdueshëm i të punësuarave në përputhje me planin dhe nevojat për trajnime | Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive | Në vazhdimësi |
| | | | | | | | Të bëhet vlerësimi i ndikimit të trajnimeve të mbajtura | Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive | Tre mujori i katërt, 2024 |
| | | | | | | | | | |
| | | Përshkrimet e vendeve të punës të nëpunësve të pa qarta, jo adekuate dhe të pa përditësuara | | 4 | 8 | 32 | Të bëhet rishikimi dhe standardizimi i detyrave të punës si dhe harmonizimi i tyre me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës. | Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive dhe udhëheqësit e sektorëve | TM3 2024 |
| | | | | | | | Shpërndarja e Kodit të Etikës për të gjithë zyrtarët komunal. | Kryetari i komunës dhe i Kuvendit, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive dhe udhëheqësit e sektorëve | Në vazhdimësi |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Mungesa e informimit dhe sensibilizimit për ekzistencën e kodit të etikës për stafin drejtues dhe stafin tjetër të komunës | | 3 | 6 | 18 | Organizimi i takimeve për informim me përmbajtjen e Kodit. | Kryetari i komunës dhe i Kuvendit, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive dhe udhëheqësit e sektorëve | Në vazhdimësi |
| | | | | | | | Organizimi i trajnimeve me stafin e komunës për kodin e etikes | Njësia e Burimeve njerëzore | Në vazhdimësi |
| | | | | | | | Të sigurohet mbajtja e takimeve të rregullta ndërmjet menaxhmentit dhe personelit për prezantimin dhe diskutimin për mekanizmat e raportimit të korrupsionit dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme | Kryetari i komunës dhe Kuvendit dhe drejtuesit e drejtorive | Në vazhdimësi |
| | | Mospranimin dhe trajtimin në mënyrë adekuate të informatave, sinjalizimeve nga sinjalizuesit/informatorët | | 6 | 8 | 48 | Caktimi i zyrtarit përgjegjës për sinjalizim | Kryetari i komunës dhe drejtuesit e drejtorive | Në vazhdimësi |
| 3. | **PLANIFIKIMI I DHE** | Planifikimi jo adekuat i buxhetit vjetor komunal | Ligjet, aktet nënligjor | 6 | 7 | 42 | Të sigurohet pjesëmarrja e të gjitha palëve relevante | Drejtoria për Buxhet dhe Financa | Në vazhdimësi |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | MENAXHIMI I BUXHETIT DHE FINANCAVE | | e; dhe aktet e brendsh me të komunës | | | | gjatë planifikimit të buxhetit; | | |
| | | | | | | | Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive përkatëse për personelin për planifikim të buxhetit | Kryetari i komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa | Çdo vit pas aprovimit të buxhetit vjetor |
| | | Shpenzimi i buxhetit jo në mënyrë adekuate dhe jo mjaftueshëm transparent | | 7 | 8 | 56 | Raportim i rregullt për shpenzimet buxhetore.<br><br>Hartimi dhe miratimi i planit të shpenzimeve | Drejtoria për Buxhet dhe Financa | Në vazhdimësi |
| | | | | | | | Publikimi i planit të shpenzimeve në ueb faqen e komunës | Njësia për Informim dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa | Në vazhdimësi |
| | | | | | | | Të sigurohet mbikëqyrja e jashtme mbi zbatimin e buxhetit duke krijuar një komision të përbërë nga përfaqësuesit e komunës dhe nga vëzhgues të OJQ-ve për të monitoruar zbatimin e buxhetit. | Kryetari i komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa | Në vazhdimësi |
| | | | | | | | Raportim i rregullt për shpenzimet buxhetore dhe realizimin e buxhetit | Drejtoria për Buxhet dhe Financa | |
| | | Inventarizimi dhe regjistrimi jo efikas i aseteve komunale | | 6 | 9 | 54 | Të përditësohet regjistri i brendshëm i aseteve të komunës | Drejtoria për Buxhet dhe Financa | Në vazhdimësi |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4. | **RUAJTJA DHE SIGURIA E TË DHËNAVE DHE DOKUMENT-ACIONIT** | Siguria e pamjaftueshme e të dhënave në sistemet e teknologjisë informative si dhe përdorimi i tyre për qëllime jo-zyrtare | Ligjet, aktet nënligjor; dhe aktet e brendsh me të komunës. | 4 | 9 | 36 | Zhvillimi dhe miratimi i procedurës së punës për proceset që realizohen përmes sistemeve të teknologjisë informative | Drejtoria e Administratës dhe sektori i TIK | Në vazhdimësi |
| | | | | | | | Takime informuese me stafin e komunës lidhur me rrezikun nga mashtrimet dhe korrupsioni që kanë të bëjnë me sigurinë e informacionit dhe shfrytëzimin e të dhënave të kompjuterizuara | Drejtoria e Administratës dhe sektori i TIK | Në vazhdimësi |
| | | Trajtimi jo adekuat i dokumentacionit zyrtar dhe informacionit | | 3 | 8 | 24 | Zhvillimi dhe miratimi i procedurës së brendshme mbi trajtimin e dokumentacionit dhe informacionit zyrtar | Kryetari i komunës, Drejtoria e Administratës | TM 2024 |

| **FUSHAT E VEÇANTA TË RREZIKUT** | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Regjistrimi i rrezikut** | | | **Vlerësimi dhe matja e rrezikut** | | | | **Veprimi ndaj rrezikut** | | |
| **Nr.** | **Fusha e rrezikut** | **Përshkrimi i Rrezikut** | **Masat ekzistuese të kontrollit** | **Gjasat** | **Ndikimi** | **Vlerësimi i rrezikut** | **Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve** | **Njësia/zyrtari përgjegjës** | **Afati i realizimit** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | **AUDITIMI I BRENDSHËM** | Mungesa e planifikimit të auditimit të bazuar në rrezik dhe auditimeve rast pas rasti | Ligjet, aktet nënligjore; dhe aktet e brendshme të komunës | 6 | 8 | 48 | Hartimi i planit të auditimit të brendshëm bazuar në rezultatin e vlerësimit të rrezikut | Kryetari i Komunës, Komisioni i auditimit, Njësia e Auditimit | Në vazhdimësi |
| | | | | | | | Të sigurohen auditime rast pas rasti për të vërtetuar të gjeturat gjatë inspektimeve | Kryetari i komunës, drejtorët e drejtorive | Në vazhdimësi |
| | | Mungesa e mbikëqyrjes adekuate, profesionale mbi zbatimin e rekomandimeve të auditorit | | 3 | 9 | 27 | Raportim i rregullt mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimit | Drejtorët e drejtorive dhe Njësia e Auditimit | Në vazhdimësi |
| | | | | | | | Zhvillimi i një plani për zbatimin e rekomandimeve të auditimit | Kryetari i komunës, Njësia e AB dhe Komisioni i Auditimit | Në vazhdimësi |
| | | Mungesa e koordinimit ndërmjet Njësisë së AB, Komisionit të Auditimit, Kryetarit dhe njësive komunale | | 3 | 8 | 24 | Të përmirësohet sistemi i komunikimit në mes njësisë së auditimit të brendshëm dhe organeve tjera komunale. | Njësia e Auditimit, komisioni i Auditimit dhe njësitë tjera komunale | Në vazhdimësi |
| 2. | **PROKURIMI PUBLIK** | Përgatitje joefikase e specifikimeve të tenderit | Ligjet, aktet nënligjore; dhe aktet e brendshme të komunës | 6 | 9 | 54 | Rritja e kapaciteteve për përgatitjen e specifikimeve të tenderit duke marrë parasysh kriteret për mos-diskriminim dhe duke siguruar qasje të barabartë | Njësia e Prokurimit dhe Njësia e Burimeve Njerëzore | Në vazhdimësi |
| | | | | | | | Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive përkatëse për personelin për | Njësia e Prokurimi | Pas miratimit të planit të prokurimit |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | prokurimin publik dhe njësitë kërkuese | | |
| | | Mos transparenca dhe mbikëqyrja e pa mjaftueshme e prokurimit publik | | 3 | 8 | 24 | Publikimi i Planit të Prokurimit në ueb faqen e komunës | Kryetari i Komunës dhe Njësia e Prokurimit | Tremujori i parë 2024 |
| | | | | | | | Të kufizohen mundësitë për komunikim me ofertuesit duke krijuar protokoll të qartë për komunikimin me ofertuesit dhe duke krijuar pika të qarta të kontaktit | Kryetari i Komunës dhe Njësia e Prokurimit | Në vazhdimësi |
| 3. | **MENAXHIMI I KONTRATAVE PUBLIKE** | Mungesa e stafit profesional për menaxhimin kontratave | Ligjet, aktet nënligjore; aktet e brendsh me të komunës | 4 | 9 | 9 | Menaxhimi i kontratave nga zyrtarët me kompetencë profesionale | Kryetari i komunës, drejtoritë komunale dhe Njësia e Prokurimit | Në vazhdimësi |
| | | | | | | | Trajnimi i zyrtarëve për menaxhimin e kontratave | Kryetari i komunës Njësia e Burimeve Njerëzore | TM3 2024 |
| | | | | | | | Kompensimi për personat e përfshirë në menaxhimin e kontratave | Kryetari i komunës dhe Njësia e Burimeve Njerëzore | TM4 2024 |
| 4. | **ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL DHE BUJQËSIA** | Mungesa apo mos rishikimi dhe përditësimi i dokumenteve strategjike për zhvillim ekonomik lokal | | 4 | 9 | 36 | Hartimi, rishikimi dhe përditësimi si dhe miratimi i dokumenteve strategjike për zhvillim ekonomik të komunës<br><br>Rishikimi i prioriteteve të zhvillimit ekonomik të komunës | Kryetari i komunës, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | TM3 2024 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Qëllimet dhe prioritetet e zhvillimit ekonomik të komunës të paqarta dhe jo-transparente. | | 6 | 8 | 48 | Të sigurohet pjesëmarrja e të gjitha palëve relevante gjatë hartimit dhe caktimit të prioriteteve të zhvillimit komunal. | Kryetari i komunës, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | TM4 2024 |
| | | Kritere jo të qarta dhe transparencë e pa mjaftueshme në ndarjen e subvencioneve | | | | | Të zhvillohet rregullativa e brendshme duke përcaktuar kritere dhe procedura të qarta për ndarjen e subvencioneve dhe për të parandaluar vendime arbitrare dhe praktika korruptive | Kryetari i komunës; Drejtoria për Zhvillim Ekonomik<br>Drejtoria për Bujqesi, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Arsimit | Në vazhdimësi |
| | | | | | | | Përfshirja e shoqërisë civile në vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve | Kryetari i komunës; Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari dhe Njësia e Burimeve Njerëzore | Në vazhdimësi |
| | | Kualifikimi i pamjaftueshëm i personelit për hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të dokumenteve për zhvillimin ekonomik lokal | | 3 | 9 | 27 | Të sigurohet personel adekuat profesional për zhvillimin ekonomik lokal | Kryetari i komunës; Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Njësia e Burimeve Njerëzore | Në vazhdimësi |
| | | | | | | | Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e zhvillimin ekonomik lokal | Kryetari i komunës, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | Në vazhdimësi |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Mbikëqyrja jo efikase mbi zbatimin e aktiviteteve të zhvillimit ekonomik lokal | | 3 | 9 | 27 | Kontrollimi dhe raportimi i rregullt për zbatimin e aktiviteteve të zhvillimit ekonomik lokal | Kryetari i Komunës, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Zyrtari Kryesor Financiar dhe Kuvendi Komunal | Çdo vit |
| | | Mos përfillja e dokumenteve strategjike gjatë planifikimit vjetor buxhetor dhe kornizës afatmesme buxhetore | | | | | Shqyrtimi i përputhshmërisë së buxhetit vjetor me dokumentet strategjike komunale | Kryetari i komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit | TM1 2024 |
| **5.** | **PLANIFIKIM I URBAN DHE RURAL** | Mangësi në rregullativen e brendshme që lidhen me fushën e planifikimit urban dhe rural | Ligjet, aktet nënligjore; aktet e brendshme të komunës dhe planet rregullative urbane | 4 | 9 | 36 | Të zhvillohet rregullativa e brendshme duke përcaktuar kritere të qarta të duhura që adresojnë rreziqet kryesore në procesin e planifikimit urban dhe rural dhe parandalojnë vendimet subjektive | Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Njësia e Burimeve Njerëzore | Në vazhdimësi |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Zbatim jo i plotë i rregullatives së brendshme që lidhen me fushën e planifikimit urban dhe rural | | 5 | 9 | 45 | Të rritet mbikëqyrja e zbatimit të rregullatives së brendshme | Drejtoria për urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Njësia e Burimeve Njerëzore | Në vazhdimësi |
| | | | | | | | Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e planifikimit urban dhe rural | Kryetari i komunës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit | Në vazhdimësi |
| | | Kualifikimi i pamjaftueshëm i personelit për hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të dokumenteve për planifikim urban dhe rural | | 3 | 9 | 27 | Të sigurohet personel adekuat profesional për planifikim urban dhe rural | Kryetari i komunës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit | Në vazhdimësi |
| | | | | | | | Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e planifikimit urban dhe rural | Kryetari i komunës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit | Në vazhdimësi |
| | | Mbikëqyrja jo efikase mbi zbatimin e aktiviteteve të planifikimit urban dhe rural | | 5 | 8 | 40 | Kontrollimi dhe raportimi i rregullt për zbatimin e aktiviteteve të planifikimit urban dhe rural | Kryetari i komunës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit | |
| 6. | **STANDARDET E NDËRTIMIT DHE KONTROLLI** | Mungesa e kontrolleve konsistente gjatë ndërtimit dhe në vend punishte | Ligjet, aktet nënligjor; aktet e brendshme të | 7 | 9 | 63 | Shtimi i kontrolleve në vendet e ndërtimit, me qëllim të ndalimit me kohë të ndërtimeve pa leje. | Drejtoria e Inspeksionit dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit | TM2 2024 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Mungesë e stafit adekuat për kontrollimin e ndërtimeve | komunës dhe planet rregullative urbane | 3 | 10 | 30 | Të sigurohet personel adekuat profesional për planifikim urban dhe rural | Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria e Inspeksionit dhe Njësia e Burimeve Njerëzore | Në vazhdimësi |
| | | | | | | | Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e planifikimit urban dhe rural | Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit | Në vazhdimësi |
| 7. | **INSPEKTIMET** | Mungesa e planifikimit të duhur të inspektimeve | Ligjet, aktet nënligjore; aktet e brendshme të komunës | 3 | 7 | 21 | Të sigurohet plani vjetor i inspektimeve për çdo fushë duke u bazuar në vlerësimin e rrezikut. | Drejtoria e Inspeksionit dhe Njësia e Burimeve Njerëzore | Në vazhdimësi |
| | | Mungesa e kapaciteteve profesionale të inspektorëve | | 5 | 8 | 40 | Organizimi i trajnimeve profesionale për inspektorët | Drejtoria e Inspeksionit, Njësia e Burimeve Njerëzore | TM3 2024 |
| | | Numër i pamjaftueshëm i inspektorëve | | 3 | 8 | 24 | Të sigurohet numër i mjaftueshëm i inspektorëve nga personeli i brendshëm i komunës ose punësime të reja | Kryetari i komunës dhe Drejtoria e Inspeksionit | TM3 2024 |
| 8. | **ARSIMI PUBLIK** | Planifikimi i shërbimeve arsimore jo adekuat dhe i paefektshëm | Ligjet, aktet nënligjore; aktet e brendsh | 3 | 9 | 36 | Të sigurohet planifikim i shërbimeve arsimore bazuar në nevojat dhe dinamikën e rritjes apo zvogëlimit të numrit të nxënësve. | Drejtoria e Arsimit | Në vazhdimësi |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | me të komunës | | | | Planifikimi i mirëfilltë i konkurseve duke u bazuar në analizë të brendshme | — | Në vazhdimësi |
| | | | | | | | Fillimi i procedurave të prokurimit me kohë për shërbimet e nevojshme në fushën e arsimit | | Në vazhdimësi |
| | | Inspektimet e pa mjaftueshme të procesit mësimor | | 3 | 8 | 24 | Të hartohet plani i inspektimeve dhe mbikëqyrja e zbatimit të tij<br><br>Hartimi i raporteve të inspektimeve. | Drejtoria Komunale e Arsimit | TM4 2024 |
| | | | | | | | Vlerësimi sistematik i performacës së punës së drejtorëve te shkollave | — | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 9. | **SHËNDETI PUBLIK** | Hapësira dhe Infrastruktura shëndetësore jo e mjaftueshme dhe jo efikase në ofrimin e shërbimeve shëndetësore. | Ligjet, aktet nënligjore; aktet e brendshme të komunës si dhe planet dhe strategjitë në shëndetësi | 5 | 7 | 35 | Të bëhet analizë e detajuar më qëllim të përcaktimit të prioriteteve për përmirësime në infrastrukturë dhe sigurimin e hapësirave të nevojshme për shërbime shëndetësore. | Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Shëndetësi | TM2 2024 |
| | | Mangësi në rregullativën e brendshme lidhur me ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe zbatimi jo i plotë i saj | | 3 | 9 | 36 | Të shtohet kontrolli i zbatimit të rregullatives. | Drejtoria për Shëndetësi dhe drejtuesit e institucioneve shëndetësore | Në vazhdimësi |
| | | | | | | | Të funksionalizohet Sistemi i informacionit Shëndetësor | Drejtoria për Shëndetësi dhe drejtuesit e institucioneve shëndetësore | TM2 2024 |
| | | Funksionimi jo efikas i Sistemit të informacionit shëndetësor. | | 3 | 8 | 24 | Të zhvillohen aktet nënligjore si dhe qartësimi i procedurave për lejet për shërbimet përkatëse publike. | Kryetari i Komunës dhe Drejtoria përkatëse për Shërbime Publike dhe licencimin e tyre | TM2 2024 |
| 10. | **SHËRBIMET PUBLIKE DHE LICENCIMI I TYRE** | Efikasiteti, efektiviteti, cilësia dhe transparenca jo e kënaqshme në ofrimin e shërbimeve publike | Ligjet, aktet nënligjore; aktet e brendshme të komunës si dhe planet dhe strategjitë në shëndetësi | 5 | 8 | 40 | Të krijohen aplikacione elektronike për shërbimet publike që mund të ofrohen në mënyre elektronike . | Drejtoria për Administratë dhe njësia e TIK-ut | |
| | | | | | | | Të zvogëlohet mundësia e kontakteve mes palëve të interesuara dhe zyrtarit që merr vendim (vendimi të merret nga zyrtari profesional, ndërsa pagesa dhe dërgimi i vendimit të bëhet në zyrat pritëse nga zyrtari tjetër | Mbikëqyrësi i Shërbimeve Publike | Në vazhdimësi |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | Të rritet profesionalizmi i stafit përmes trajnimeve, shkëmbimit të përvojave dhe punëtorive | Drejtoria përkatëse për Shërbime Publike dhe Njësia e Burimeve Njerëzore | Në vazhdimësi |
| | | Mangësi në rregullativën e brendshme lidhur me licencimin e shërbimeve | | 4 | 9 | 36 | Të zhvillohet rregullativa e brendshme duke përcaktuar kritere të qarta që adresojnë rreziqet kryesore në procesin e licencimit dhe parandalojnë vendimet subjektive | Kryetari i Komunës dhe Drejtoria përkatëse për licencimin e shërbimeve | TM3 2024 |
| | | Kualifikimi i pamjaftueshëm i personelit për licencimin e shërbimeve | | 3 | 9 | 27 | Të sigurohet trajnimi i stafit për licencimin e shërbimeve | Drejtoria përkatëse për licencimin e shërbimeve dhe Njësia e Burimeve Njerëzore | Në vazhdimësi |
| 11. | **KOMUNIKIMI ME PALË TË JASHTME TË INTERESIT** | Mungesa e transparencës dhe konsultimeve me palë të jashtme të interesit gjatë hartimit të rregulloreve dhe buxheteve komunale | Ligjet, aktet nënligjore; aktet e brendshme të komunës | | 8 | 40 | Të rritet transparenca dhe të merren masa për konsultime me palë të jashtme të interesit gjatë zhvillimit të rregulloreve komunale dhe të buxhetit (postimi i projekt-rregulloreve në ueb faqe, inicimi i diskutimeve publike, fokus grupe etj.) | Kryetari i Komunës, Drejtoria përkatëse dhe Njësia e Informimit | Në vazhdimësi |
| | | Mungesa e partneritetit me shoqërinë civile në fushën e anti-korrupsionit dhe | | 5 | 9 | 45 | Të forcohen mekanizmat e konsultimeve me bizneset përmes takimeve periodike konsultative | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | bashkëpunimit me komunitetin e bizneseve | | | | | Të rritet rrjedha e informacionit drejt medias dhe publikut lidhur me parandalimin e korrupsionit dhe të aktiviteteve të luftës kundër tij | | |
| | | | | | | | Të zhvillohen partneritete me shoqërinë civile në fushën e anti-korrupsionit duke themeluar grupe pune teknike për menaxhimin e riskut në fushat e ndjeshme dhe të brishta ndaj korrupsionit dhe të sigurohet përfshirja e OJQ-ve. | | |